



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1494 Prot.

Tiranë, më 16.02.2023

VENDIM

Nr. 6, datë 16/02/2023

MBI

**“MIRATIMIN PËR TRANSFERIMIN PA PAGESË TË 2 (DY) PIANOVE NË SHKOLLAT E CIKLIT TË ULËT, PUBLIK”**

Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkresës nr. 40 prot., datë 13.01.2023 të FM “Kërkesë për nxjerrje jashtë përdorimi të pianove të FM” si dhe Proces-verbalit mbi vlerësimin teknik dhe financiar të Komisionit të ngritur në bazë të Urdhërit nr. 12, datë 03.02.2023 “Mbi ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve”, pasi e diskutoi,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e transferimit pa pagesë të 2 (dy) pianove të Fakultetit të Muzikës në shkollat e ciklit të ulët, publik, mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**


**Lavdrim SAHITAJ**

  
\_\_\_\_\_  
(Kryetar)

**Prof. Besnik Bisha**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Jeton SHEHU**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Prof.Asoc.Dr./Sokol SARAÇI**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)


**Ergis SEFA**

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Lorenc VANGJELI**

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Vladimir LLAKAJ**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
ADMINISTRATOR

144/3  
Nr. \_\_\_ Prot

Datë 13/02/2023

RELACION

**Lënda:** Relacion mbi vlerësimin e pianove dhe transferimin e tyre pa pagesë për shkollat e ciklit të ulët

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Bazuar në ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe shkresës së ardhur nga Fakulteti i Muzikës nr.40, datë 13.01.2023 “Kërkesë për nxjerrje jashtë përdorimi të pianove të FM” ka dalë Urdhëri nr.12, datë 03.02.2023 “Mbi ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve”.

Në zbatim të urdhërit, komisioni ka ndjekur procedurën për vlerësimin e tyre dhe më datë 08.02.2023 ka paraqitur proces-verbalin.

Komisioni punoi me metodën që aktivi është shqyrtuar si nga ana teknike dhe nga ana financiare si dhe bëri vlerësimin e tyre në prani të personave me përgjegjësi materiale.

Institucioni nuk ka nxjerrë jashtë përdorimi vegla muzikore dhe rezulton se të dy pianot e mëposhtëme janë të amortizuara. Vlera e mbetur e tyre është (zero) lekë.(paraqitur dhe në tabelën bashkëlidhur)

1. August Forster ½ Coda
2. Lirika Mod 120

Pianot i kanë kaluar të gjitha procedurat e mirëmbajtjes dhe riparimit ambulator në Fakultetin e Muzikës. Giendia teknike e tyre nuk i përgjigjet profesionalisht procesit mësimor dhe studimor në Fakultetin e Muzikes.

Komisioni i vlerësimit, nisur mbi gjendjen teknike të tyre, kohën e shfrytëzimit dhe të vënies në punë, mundësinë e rivënies në punë, *(ku këto aktive janë bërë hyrje në vitin 1974 dhe në vazhdim)* raportin kosto përfitim, pasi vlerësoi ato, vendosi të propozoj që të krijohet mundësia që pianot të transferohen pa pagesë për shkollat e ciklit të ulët, publik në zbatim të pikës 108 ku citohet: *Aktivitet afatgjatë që konsiderohen të panevojshme për njësinë në një periudhë të mevonshme të funksionimit të saj (në rast mbylljeje/shkrirjeje të njësisë, ndryshimi të misionit apo objektivave afatgjatë të njësisë), por që mbeten në gjendje përdorimi mund të jepen në rend shterues (nga a në b).*



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

- a. transferohen pa pagese në një njësi tjetër publike brenda sektorit të qeverisjes së përgjithshme.  
Konfirmimi zyrtar nga njesia perfituese verteton perfundimin e transaksionit;*
- b. shiten në formën e ankandit publik*

Bashkëlidhur ndodhet tabela analitike e dy pianove të vlerësuara dhe tabela e përlogaritjes së normës së amortizimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



Njesia	Personi përgjegjës	Llog.	Nën/ llog	Viti i hyrjes	Nr. Rend.	Emertimi	Njësia	Sasia (1)	Cmimi i blerjes (Lek) (2)	Shuma (Lek) (3)=(1)x(2)	Vlera e amortizimit (Lek)	Përshkrimi mbi gjëndjen
FM	Nermi Zebi	214	O140	1974	1	Piano Lirika Mod 120	cope	1	15,000	15,000	15,000	Giendia teknike nuk i përgjigjet profesionalisht procesit mësimor dhe studimor
FM	Nermi Zebi	214	O140	1974	2	Piano August 135465	cope	1	80,959	80,959	80,959	Giendia teknike nuk i përgjigjet profesionalisht procesit mësimor dhe studimor
<b>Shuma</b>								<b>2</b>	<b>95,959</b>	<b>95,959</b>	<b>95,959</b>	